



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria -Vlada-Government*

Ministria e Mjedisit ,Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës  
Ministarstvo Zivotne Sredine, Prostornog planiranja i Infrastrukture  
Ministry of Environment , Spatial Planning and Infrastructure

Zv.Ministri i Ministrisë së Mjedisit Planifikimit, Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 145 (paragrafi 2), të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit nr. 06/L-113 për Administratën Shtetërore dhe të Agjencive të pavarura, (Gazeta Zyrtare, Nr. 7/ 01 mars 2019), bazuar ne dispozitat e nenit 7 (paragrafi 2) të Udhëzimit Administrativ Nr.06/2016 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 09/2013 për rrjetin e linjave dhe rendin e udhëtimit në transportin ndër urban të udhëtarëve me autobus dhe nenit 8 (paragrafi 3) të Rregullores nr. 14/2023 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenin 131 të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenin 5 dhe 21 të Ligjit nr.04/L-179 për Transportin Rrugor, nenin 7 të Udhëzimit Administrativ 09/2013 për rrjetin e linjave dhe rendin e udhëtimit të transportit ndërurban të udhëtarëve me autobus dhe rekomandimit të komisionit profesional, nxjerr këtë

## VENDIM

**I. Aprovohet**, kërkesa nr.8664; 8665; 8666 dhe 8667 date 14.11.2023 e operatorit të transportit rrugor të udhëtarëve me autobus "MEMI TRAVEL" shpk me seli në Skenderaj për marrjen e nisjeve ne relacionin Drenas-Prishtinë me oraret e nisjeve (13:45 - 15:00) nisjeve ne relacionin Skenderaj -Drenas - Prishtine me oraret e nisjeve (06:35-10:00) nisjeve ne relacionin Prishtine- Drenas - Skenderaj me oraret e nisjeve (06:45-08:40; 15:15-17:40) dhe nisjeve ne relacionin Skenderaj-Drenas me oraret e nisjeve (13:00-16:00).

## *Arsyetim*

Pas shqyrtimit të aplikacioneve dhe verifikimit të dokumentacionit dhe shkresave të tjera të lëndës dhe duke u bazuar në legjislacionin në fuqi repektivisht Ligjin nr.04/L-179 për Transportin Rrugor në mbështetje të nenit 8 të Udhëzimit Administrativ nr. 09/2013 mbi rrjetin e linjave dhe rendin e udhëtimit të transportit ndër-urban të udhëtarëve me autobus i plotësuar dhe ndryshuar me Udhëzimin Administrativ nr.06/2016, është konstatuar që operatori transportues rrugor të udhëtarëve me autobus "MEMI TRAVEL" shpk me seli në

Skenderaj, ka plotësuar kushtet ligjore për ndarjen e nisjeve të lira në relacionet e lartëcekur të përcaktuara sipas nenit 8 të U.A nr. 09/2013 për rrjetin e linjave dhe rendin e udhëtimit në transportin nderurban të udhëtarëve me autobus si dhe kushtet e shpalljes publike për marrjen e nisjeve ne relacionin Drenas-Prishtinë me oraret e nisjeve (13:45 - 15:00) nisjeve ne relacionin Skenderaj -Drenas - Prishtine me oraret e nisjeve (06:35-10:00) nisjeve ne relacionin Prishtine- Drenas - Skenderaj me oraret e nisjeve (06:45-08:40; 15:15-17:40) dhe nisjeve ne relacionin Skenderaj-Drenas me oraret e nisjeve (13:00-16:00).

Andaj në bazë të kësaj që u tha më lartë, është vendosur si në dispozitiv.

### **Këshilla Juridike:**

Kundër këtij Vendimi pala e pa kënaqur mund të parashtojë ankesë në Ministrinë e Mjedisit Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës brenda afatit prej shtatë (7) ditësh nga dita e publikimit të vendimit.



I dërgohet:

- Kabinetit të Ministrit;
- Kabinetit të Sekretarit të Përgjithshëm;
- Departamentit të Transportit Tokësor;
- Operatorit Transportues;
- Arhivit.